

STUDIM

Studim dedikuar identifikimit të nevojave dhe potencialeve të të mbijetuarve të DHSBGJ për pjesëmarrjen e tyre në Qeverisje dhe mundësitë e punësimit në Kosovë

RAPORTIMI I TË GJETURAVE:

Studim dedikuar identifikimit të nevojave dhe potencialeve të të mbijetuarve të DHSBGJ për pjesëmarrjen e tyre në Qeverisje dhe mundësitë e punësimit në Kosovë

Maj 2017

"Ky studim u mundësua nga Programi Angazhimi për Barazi (E4E), financuar nga Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC. Përmbajtja është përgjegjësi e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës ,Qendrës për Promovimin e Familjes së Shëndoshë, dhe Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave, dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pikëpamjet e Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara."



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Autorët:

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë
Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave

Studim dedikuar identifikimit të nevojave dhe potencialeve të të mbijetuarve të DHSBGJ për pjesëmarrjen e tyre në Qeverisje dhe mundësitë e punësimit në Kosovë

Përmbajtja

Përkufizimi i terminologjisë kyçe	6
Shkurtesat dhe Akronimet	8
Përmbledhja.....	9
Abstakti.....	12
Hyrja dhe metodologjia.....	3
Dobësitë dhe boshllëqet.....	14
Pjesëmarrja ekonomike.....	14
Fuqizimi ekonomik.....	14
Shkathësitë sociale dhe angazhimi personal.....	15
Metodologjia e studimit.....	15
Të gjeturat kryesore dhe konkluzionet.....	17
6.1 Realitete sfiduese... ..	17
6.2 Profilizimi i grave të mbijetuara të DHSBGJ.....	17
6.3 Dokumentimi i dëmeve shoqerore.....	18
6.4 Konteksti ligjor dhe institucional.....	19
6.5 Fuqizimi ekonomik si përgjigje ndaj përjashtimit shoqëror.....	20
6.6 Ekonomia sociale dhe roli i sektorit civil si përgjigje ndaj krizës së shtetit social.....	21
Konkluzionet.....	22
Rekomandimet.....	23
Falenderime.....	25
Shtojcat.....	
Shtojca 1: Pyetësori.....	

Përkufizimi i terminologjisë kyçe

Përderisa nuk ekziston ndonjë pajtim i vetëm mbi kuptimin e terminologjisë kyçe për integrimin shoqëror, përfshirjen shoqërore, kohezionin shoqëror dhe pjesëmarrjen shoqërore, atëherë përkufizimet e mëposhtme janë përdorur në këtë studim.

Fuqizimi- është bazuar në besimin se gratë viktimat të DHSBGJ duhet të kenë qasje në informacion, edukim, perkrashje të nevojshme shoqërore dhe ekonomike, në mënyrë që vendimet e marra t'i reflektojnë më së miri interesat dhe nevojat e tyre. Në vend që të merren me statusin e tyre, qasja fuqizuese u mundëson viktimave që përmes shpërndarjes së njohurive, trajnimeve dhe konsultimeve, të krijojnë një grup shërbimesh që ato vetë i kontrollojnë, siç është post-viktimizimi dhe minimizimi i rrezikut. Kjo qasje, gjithashtu mund të zgjerohet te komunitetet, duke i lejuar ata që të veprojnë bashkarisht në adresimin gjithpërfshirës të çështjeve të veçanta.

Fuqizimi Ekonomik - Fuqizimi ekonomik është aftësia e grave dhe burrave për të marrë pjesë, kontribuar dhe përfituar nga proceset rritëse përmes rrugëve të cilat njohin vlerën e kontributeve të tyre, respektojnë dinjitetin e tyre dhe mundësojnë negociimin e shpërndarjes së fer dhe korrekt të përfitimeve.

Përfshirja Shoqërore – është interpretuar si një proces me të cilin janë bërë përpjekje për të garantuar mundësi të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre, kështë që ata mund të përmbushin qëllimin e tyre në jetë. Është një proces multi-dimensional që ka për qëllim krijimin e kushteve që do t'ua mundësonin pjesëmarrjen e plotë dhe aktive për të gjithë anëtarët e shoqërisë në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë aktivitetet qytetare, shoqërore, ekonomike dhe politike, si dhe pjesëmarrjen në proceset vendim-marrëse¹.

Integrimi Shoqëror- është interpretuar si një proces dinamik dhe parimor i promovimit të vlerave, marrëdhënieve dhe institucioneve të cilat mundësojnë që të gjithë njerëzit të marrin pjesë në jetën shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike mbi bazën e të drejtave të barabarta, ndershmerisë dhe dinjitetit. Në një mënyrë – ndërtimi i komuniteteve dhe shoqërive që janë bazuar në promovimin dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njeriut, si dhe në respektimin dhe vlerësimin e dinjitetit të çdo individi, diversitetit, pluralizmit, tolerancës, jo-diskriminimit, jo-dhunës, mundësive të barabarta, solidaritetit,

1 White Paper "Kosovo Social Inclusion Challenges" <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/kosovo-social.pdf>

sigurisë dhe pjesëmarrjen e të gjithë njerëzve, duke përfshi personat dhe grupet e pafavorizuara dhe të rrezikuara².

Fuqizimi Shoqëror – është nënkuptuar si proces i zhvillimit të një kuptimi të autonomisë dhe vetë-besimit, si veprim individual dhe kolektiv i cili ndryshon marrëdhëniet, institucionet dhe diskursat të cilat përjashtojnë njerëzit e varfër dhe i mbajnë ata në mjerim.

Përjashtimi Shoqëror- është nënkuptuar si gjendje (barrierat dhe proceset) e cila pengon përfshirjen shoqërore. Përjashtimi shoqëror është një proces përmes të cilit individët apo grupet janë të përjashtuar pjesërisht apo tërësisht nga pjesëmarrja e plotë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në të cilën ata jetojnë, mbi bazën e identiteteve shoqërore siç është: mosha, gjinia, raca, etniciteti, kultura, gjuha, dhe/ose disavantazhet fizike, ekonomike apo shoqërore. Përjashtimi shoqëror mund të nënkuptojë mungesën e zërit, mungesën e njohjes, apo mungesën e kapaciteteve për pjesëmarrje aktive. Gjithashtu, mund të nënkuptojë përjashtimin nga puna e denjë, pasuritë, pronat, mundësitë, qasja në shërbimet sociale dhe/ose përfaqësimi politik.

Kohezioni Shoqëror- *i referohet fundamenteve që sjellin dhe mbajnë njerëzit së bashku në shoqëri. Në një shoqëri kohezive të gjithë individët dhe grupet kanë ndjenjën e përkatësisë, pjesëmarrjes, përfshirjes, njohjes dhe legjitimitetit.*

Pjesëmarrja Shoqërore – është nënkuptuar si akt i angazhimit në aktivitetet e shoqërisë. *I referohet mundësisë për të ndikuar vendimet si dhe për të pasur qasje në proceset vendim-marrëse. Pjesëmarrja shoqërore ndërton besim reciprok në mes të individëve, e cila përbën bazën për ndarjen e përgjegjësisë karrshi komunitetit dhe shoqërisë.*

² Udhëzimet e integruara për politikat ekonomike dhe të punësimit të Shteteve Anëtare, Udhëzimi 10: Promoting social inclusion and combating poverty; page 22; <http://ec.europa.eu/eu2020/pdf/Brochure%20Integrated%20Guidelines.pdf> last accessed Dhjetor, 2016

Shkurtesat dhe Akronimet

ATRC	Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim
QPFSH	Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë
QPDG	Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
OZHQ	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
DHSBGJ	Dhuna Seksuale dhe në Baza Gjinore
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Përmbledhja

Fuqizimi ekonomik i grave është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje në favor të të varfërve. Fuqizimi ekonomik i grave duhet të kërkojë politika publike të zëshme, një qasje holistike dhe angazhim afat-gjatë, gjithashtu çështje të veçanta gjinore duhet të integrohen qysh në fazën dizajnuese të politikave dhe programeve. Fuqizimi ekonomik rritë qasjen e grave në resurset dhe mundësitë ekonomike, duke përfshi punësimin, shërbimet finaciare, pronën dhe asetet tjera prodhuese, zhvillimin e shkathtësive si dhe njohuri mbi tregun.

Rasti i Kosovës ilustron më së miri rolin që gratë luajnë në ndërtimin e një ambienti të qëndrueshëm post-konfliktuoz dhe sa e rëndësishme bëhet siguria njerëzore me karakter gjinore. Realitetet e ditëve të sotit tregojnë nevojën për më shumë përkrahje duke pasur parasysh pavarësinë ekonomike dhe finaciare të grave viktime të DHSBGJ dhe të minoriteteve të marginalizuara, nevojën e tyre për më shumë përkrahje në edukim dhe (vetë)punësim, në të gjitha nivelet. Niveli i stigmës dhe diskriminimit pozitiv, në vazhdimësi kanë ngritur çështjen e fuqizimit ekonomik si një çështje e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Duke pasur para sysh rolin që gratë luajnë në familje, dhe nëpërkëmbjen e rolit të tyre në komunitete, nevoja për më shumë ndërhyrje të orientuara kah komuniteti mbetet prioritet për të ardhmën.

Me qëllim të vlerësimit të zhvillimit të trendeve aktuale dhe rolit jopërfaqësues të grave viktime të DHSBGJ dhe grave tjera të marginalizuara dhe papërfaqësuar, siç është komuniteti RAE, Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë, në partneritet me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave ka kryer një studim për këtë dukuri. Studimi mbi Fuqizimin Ekonomik dhe Përfshirjen Shoqërore të viktimave të DHSBGJ në Kosovë është rezultat i punës hulumtuese të planifikuar për t'u realizuar dhe për të orientuar ndërhyrjet të cilat kanë pasuar implementimin e një projekti 12-mujor dedikuar promovimit të grave/të mbijetuara të dhunës seksuale në qeverisje dhe fuqizimin e tyre ekonomik përmes përmirësimit të politikave publike, përfaqësimit, punësimit, edukimit dhe pjesëmarrjes. Iniciativë kjo e përkrahur nga ATRC/USAID.

Ky studim analizon të dhënat e mbledhura gjatë implementimit të programit, përmes intervistave, takimeve, aktiviteteve lokale dhe fokus grupeve dedikuar viktimave të dhunës seksuale, individëve të (pa) identifikuar që kanë nevojë për shërbime, dhe familjeve të tyre të cilat vuajnë në heshtje. Kësisoj, ky studim ka për qëllim identifikim e grupeve më vulnerabël që janë më të prirura për t'u ekspozuar përjashtimit shoqëror siç është komuniteti RAE si dhe hartëson të gjitha ndërhyrjet e kryera nga aktorë të ndryshëm që kontribuuan në fuqizimin ekonomik dhe përfshirjen shoqërore e grupeve të identifikuar vulnerabël. Përveç kësaj, ky studim jep rekomandime në lidhje me gjendjen e këtyre kategorive të popullatës, të cilat supozohet të jenë grupe më vulnerabël, duke identifikuar faktorët kryesorë, nënvizuar pozitën e tyre socio-ekonomike, edukimin, gjendjen shëndetësore dhe (pa) aftësitë.

Pavarësisht të arriturave në implementimin e decentralizimit, në Kosovë modeli i mbrojtjes sociale gjërësisht është i ndikuar nga kufizimet finaciare. Përderisa skema sociale është gjërësisht e varuar nga kontributet e të punësuarve, në anën tjetër numri i të përjashtuarve nga shoqëria është në rritje (të moshuarit dhe veteranët e luftës, personat me aftësi të kufizuara, personat me stress post-traumatik, personat e papunë për kohë të gjatë,, gratë

dhe vajzat në vendet rurale, fëmijët si pjesë të familjeve të varfëra, komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas, etj)³.

Skema bazë e asistencës sociale është e dizajnuar në atë mënyrë që bën dallimin në mes të atyre që janë të aftë për punë dhe atyre që nuk janë, dhe atyre me ose pa fëmijë të varur⁴, duke mundësuar përfitimet si i papunë dhe përfitimet për fëmijë; pason skema e pensioneve dhe skema e shumave për personat me aftësi të kufizuara; ndërsa, për viktimat e DHSBGJ është aplikuar një kornizë e veçantë ligjore ku është njohur statusi i tyre si viktimat të luftës.

Të dhënat për grupet e observuara janë nxjerr nga diskutimet në fokus grupe dhe intervistat e realizuara me dy target grupet e mëposhtme. Grupi i parë ka përfshi 40 gra të cilat kanë pësuar dhe përjetuar mizoritë e luftës, të mbijetuara të dhunës seksuale dhe gjinore dhe që kanë humbur të afërmit e tyre familjar në regjionin e Drenasit/Glogovac ku stigma dhe paragjykimet për më shumë se 250 gra të mbijetuara të dhunës seksuale dhe asaj gjinore, pengojnë integrimin e tyre në shoqëri.

Traget grupi i dytë ka përfshirë komunitetin RAE në komunën e Gjilanit/Gnjilane, ku një realitet mjaft kompleks prej 300 njerëzish, gratë dhe vajzat çdo ditë e më tepër janë të ekspozuara ndaj dhunës seksuale dhe dhunës në baza gjinore, martesës së hershme (me forcë), dhunës fizike dhe abuzimit psikologjik, mohimit të resurseve/mundësive/ dhe shërbimeve.

Rezultatet e Studimit për të dyja grupet tregojnë që edhe pse ekziston një trend që ndërlidh problemet ekonomike dhe mungesën e përfaqësimit të grave me varfërinë, rastet e shqyrtuara dhe tregimet e ndara reflektojnë probleme më të thella të cilat lidhen me ndikimet dhe rrethanat socio-kulturale ose ideologjike. Në të dyja rastet mund të themi se fuqizimi ekonomik mund të jetë i dobishëm për këtë kategori të grave, në rast se (a) rrit fuqinë e gruas brenda familjes dhe aftësinë për të rindërtuar jetën për veten dhe fëmijët e saj; (b) gratë aftësohen se si t'i negociojnë raportet gjinore në familje; ose (c) në nivel komuniteti gruaja kontribuon në ndryshimin e pushtetit në aspekti gjinor, qëndrimeve, si dhe mos pranimit të përdëshkueshmërisë në rastet që kanë të bëjnë me viktimat e DHSBGJ.

Në anën tjetër, të ardhurat financiare “të pajustificuara” për gratë viktimat të DHSBGJ, mbetet një kërcënim i pranishëm për marginalizim të mëtutjeshëm, izolim dhe frikë. Aktualisht, të mbijetuarat e dhunës seksuale nga lufta kanë hapsirë të kufizuar ku do të mund të dëgjoheshin apo të kontribuonin në proceset e rëndësishme që janë ndërmarrë në interes të tyre. Mungesa e komunikimit apo komunikimet e vonuara si dhe gjuha mjaft e komplikuar ligjore dhe administrative kanë bërë që të mbijetuarit të mos jenë të vetëdijshëm për mundësitë e përfitimeve sociale dhe ekonomike, edukative dhe për orientimet profesionale, duke u shkaktuar kështu më tepër ankth dhe pakënaqësi. Qasja në strukturat dhe programet që do të mund të ndihmonte në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre, mbetet e vështirë.

3 Raporti I UNDP mbi Përfshirjen Sociale, 2010

4 Ligji për Aistencë Sociale 2003 (Ligji 2003/13): Kategoria I përfituesit janë ato familje ku askush nuk është i aftë për punë, dhe / ose ku vetëm një i rritur i aftë për punë dhe kujdeset për një personi të paaftë mbi 65 vjeç, dhe i cili nuk ka të ardhura dhe jo më shumë se gjysmë hektari tokë. Kategoria II përfituesit përfshijnë familjet ku çdo anëtar i aftë për punë është i regjistruar si të papunë, dhe e cila ka një fëmijë nën 5 vjeç ose ofron kujdes me orar të plotë për një jetim.

Në këtë kontekst, çështja e kthimit e familjeve Rome nga Kosova dhe riintegrimi i Romëve të riatdhesuar mbetet një sfidë serioze. Vlen të theksohet se që nga viti 1999, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në Gjilan, ka regjistruar 374 të kthyer të komunitetit Romë, të cilët janë asistuar përmes programeve për kthim, kryesisht të financuar nga organizata të ndryshme ndërkombëtare. Ministria për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me komunën e Gjilanit kanë ndarë hapësirën dhe kanë financuar ndërtimin e shtëpive për të kthyerit. Një tjetër faktor negative që ka ndikuar në procesin e kthimit të Romëve është shkatërrimi i pronave të tyre në komunën e Gjilanit dhe/ose zaptimet ilegale të këtyre pronave. Ky është një aspekt vital në vazhdimin e një jete normale, pasi që prona përbën bazën e problemeve të vazhdueshme që ndërlidhen me martesat, humbjen e intergritetit përmes dhunës, etj.

Rritja e shkëmbimit/komunikimit në mes të mbijetuarve dhe familjeve të tyre me autoritetet lokale, është një nevojë e vazhdueshme, me qëllim të familjarizimit me sfidat që të mbijetuarit ballafaqohen në qasjen dhe maksimalizimin e shërbimeve sociale dhe beneficioneve tjera lidhur me statusin e tyre.

Për më tepër, në këtë studim janë përshkruar një sërë rekomandimesh që në mënyrë të duhur kanë adresuar fuqizimin ekonomik të grave.

Në përgjithësi, rekomandimet janë fokusuar në qasjen holistike dhe kontekstuale drejt riintegritit ekonomik të të mbijetuarve përmes integritit të programeve ekzistuese dhe ngjarjeve të suksesshme si pjesë e një Strategji Kombëtare për fuqizimin ekonomik të gruas dhe zhvillimin e një plani për veprim, të përshtatur sipas Regjioneve të Kosovës dhe komuniteteve; sigurimi i pjesëmarrjes dhe qasja e të mbijetuarve në dizajnimin e programeve në të ardhmën që mund t'i ndihmonin të mbijetuarit në rindërtimin e jetës së tyre; edukimi i vazhdueshëm i komuniteteve mbi dhunën seksuale dhe nënvizimi i ndërlidhjes në mes të abuzimit në të kaluarën dhe dhunës që ndodh në vazhdimësi.

Përtej ofrimit të resurseve ekonomike dhe trajnimeve për aftësi teknike, kjo qasje holistike mund të jetë e dobishëm në ofrimin e hapësirave vetëm për gra, që do të inkurajonte formimin e rrjeteve shoqërore (ku ato do të mund t'i diskutonin sfidat, ndanin këshillat dhe të mësonin më shumë për shërbimet lokale).

Së fundi, edukimi dhe komponentët e ngritjes së vetëdijes duhet të përfshijnë gjeneratat e reja dhe mundësisht partnerët meshkuj të përfitueseve femra – qoftë vetëm ose bashkarisht me gratë – me qëllim që të minimizojë rezistencën dhe reagimin eventual. Puna me burrat duhet fokusuar në nxitjen e qëndrimeve sa më të pakta të njëanshme gjinore, normave dhe besimeve, promovimin e drejtave të grave, respektimin e ndërsjelltë dhe komunikimin e hapur, krijimin e një kuptimi të përbashkët mbi përfitimet nga fuqizimi ekonomik i grave dhe dëmeve të shkaktuara nga abuzimet në të kaluarën dhe dhunës që ndodh në vazhdimësi.

Abstrakti

Studimi “dedikuar identifikimit të nevojave dhe potencialeve të të mbijetuarve të DHSBGJ për pjesëmarrjen e tyre në Qeverisje dhe mundësitë e punësimit në Kosovë” është rezultat i punës hulumtuese të planifikuar për t’u realizuar dhe për të orientuar ndërhyrjet të cilat kanë pasuar implementimin e një projekti 12-mujor dedikuar promovimit të grave/të mbijetuara të dhunës seksuale në qeverisje dhe fuqizimin e tyre ekonomik përmes përmirësimit të politikave publike, përfaqësimit, punësimit, edukimit dhe pjesëmarrjes, iniciativë kjo e përkrahur nga ATRC/USAID, dhe implementuar nga Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë, në partneritet me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave.

Ky Studim adreson dy pyetje kërkimore. E para, analizon si dhe në çfarë mase gratë në Kosovë i kanë mbijetuar vështirësive në luftë dhe pas luftës përmes mjeteve formale dhe joformale (*informacioni duhet të përfshij të dhënat dhe rastet nga mizoritë/mbijetimet e luftës, që do të duhet të kishin të drejtë të përfitonin integritimin social, ekonomik dhe moral, reparacionin dhe kompenzimin për të gjitha dëmet e shkaktuara*). E dyta, vlerëson rolin që gratë viktime të DHSBGJ mund ta kenë në realizimin e fuqizimit të barabartë dhe për më tepër, në zhvillimin dhe rindërtimin ekonomik të Kosovës. Duke njohur pjesëmarrjen e tyre në sektorin për zhvillim dhe tregun e punës, ky studim jep rekomandime lidhur me gjendjen e këtyre kategorive të popullatës të cilat supozohet të jenë më mesin e grupeve më vulnerabël, duke identifikuar faktorët kryesorë, nënvizuar pozitën e tyre socio-ekonomike, edukimin, gjendjen shëndetësore dhe (pa) aftësitë.

QPFSH në të kaluarën ka bashkëpunuar me QKRMT në realizimin e kampanjës kombëtare “Dëgjo zërim tim”, ku bashkërisht janë realizuar aktivitete dedikuar qasjes së grave/viktima të dhunës seksuale në shërbimet sociale dhe të rehabilitimit. Ekspertiza e QPFSH ka kontribuar në zhvillimin e standardeve mbi përfshirjen shoqërore dhe rehabilitimin për gratë dhe familjet të cilat kanë pësuar nga lufta në Kosovë, duke ju ndihmuar në tejkalimin e traumës së përditshme.

QKRMT është një organizatë jo-qeveritare e cila vepron që nga viti 1999 dhe ofron shërbimet e saja për rreth 18 000 njerëz. Që nga themelimi, QKRMT vepron me partnerë të ndryshëm në përmblyshjen e objektivave të saja duke ofruar shërbime në fushën e Rehabilitimit, Hulumtimit dhe Dokumentimit, si dhe në fushën e Të Drejtave të Njeriut dhe Avokimit.

QPDG është një organizatë lokale, e cila punon me gratë të mbijetuara të DHSBGJ, në regjionin e Drenasit.

Hyrja dhe metodologjia

Në një ambient post-konfliktuoz me tënsione ndëretnike të vazhdueshme dhe një ekonomi jo stabile, gratë kanë dalë si një grup shoqëror që kanë vuajtur krimet e luftës (përdhunimet, rrahjet, vrasjet) dhe format tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut. Zhvillimet që pasuan sollën një numër të padokumentuar të tregimeve, familje të thyera, komunitete të shkatërruara dhe në konflikt, të cilat sollën para sfidave serioze iniciativat që kishin për qëllim trajtimin e të kaluarës dhe krimeve të luftës.

Zëri që ngritën organizatat e shoqërisë civile, si diskutimi mbi krimet e luftës, dhuna seksuale dhe përdhunimet si instrumente të luftës, iu bashkangjitën edhe nivele të ndryshme të Qeverisë dhe Presidentja e Kosovës përmes themelimit të Këshillit Kombëtar për mbrojtjen e viktimave të luftës. Kampanjat avokuese të fokusuar në dhunën seksuale nga koha e luftës, që pjesërisht kishin nisur pas vitit 2012, kanë thyer heshtjen paraprake mbi të mbijetuarat e DHSBGJ dhe njohjen e statusit të tyre si viktimat civile të luftës. Në vitin 2012 filluan përpjekjet lobuese për amendementimin e ligjit që njihte statusin dhe përfitimet për martirët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, veteranët dhe viktimat civile (të vdekurit, humburit dhe plagosurit)⁵. Ky amendamentim kishte për qëllim përfshirjen e viktimave të dhunës seksuale nga koha e luftës, si viktimat civile. Në vitin 2014 një draft amendamentit i bërë nga Parlamenti, i cili njihte statusin e viktimave të dhunës seksuale nga koha e luftës dhe rregullonte beneficionet për këtë kategori, kishte kaluar⁶. Ndërsa draft rregullorja dedikuar implementimit të këtyre ndryshimeve legjislative ishte aprovuar në dhjetor 2015. Kjo rregullore ofron bazën e themelimit të Komisionit për verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale nga koha e luftës, dhe siguronte shpërndarjen e beneficioneve ashtu sic ishin paraparë me ligj⁷.

Në një konteskt të tillë ligjor dhe qasje shumë dimensionale nga agjensi të ndryshme, mund të mendohet se shqetësimet e vërteta ishin adresuar, të cilat në fakt edhe janë adresuar; megjithkëtë, gjendje aktuale e grave si viktimat të luftës ka stagnuar: pa të drejta të qarta dhe të kuptueshme për tu zbatuar, pa mekanizma të definuar, dhe çka është më e rëndësishmja pa një qasje lokale që do t'i fuqizonte kategoritë e tilla dhe të thyente izolimin e tyre.

Me qëllim të vlerësimit të zhvillimit të trendeve aktuale dhe rolit jopërfaqësues të grave viktimat të DHSBGJ dhe grave tjera të marginalizuara dhe papërfaqësuar, siç është komuniteti RAE, Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë, në partneritet me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave ka kryer një studim për këtë dukuri. Ky studim analizon të dhënat e mbledhura gjatë implementimit të programit, përmes intervistave, takimeve, aktiviteteve lokale dhe fokus grupeve dedikuar viktimave të dhunës seksuale, individëve të (pa) identifikuar që kanë nevojë për shërbime, dhe familjeve të tyre të cilat vuajnë në heshtje. Kësisoj, ky studim ka për qëllim identifikim e grupeve më vulnerabël që janë më të prirura për t'iu ekspozuar përjashtimit shoqëror siç është komuniteti RAE si dhe hartëson të gjitha ndërhyrjet e kryera nga aktorë të ndryshëm që kontribuan në fuqizimin ekonomik dhe përfshirjen shoqërore e grupeve të identifikuara vulnerabël.

5 Ligji nr. 04/L-054 Statusi dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, 8 Dhjetor 2011 Kosovë.

6 Ligji nr. 04/L-172 Ndryshim Plotësimet e Ligjit nr. 04/L-054 Statusi dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, 20 Mars 2014

7 Rregullorja nr. 22/2015 Mbi Definimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimës të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës Çlirimtare në Kosovë, 2 Shkurt 2016

1. Dobësitë dhe boshllëqet

Meqenëse gratë në Kosovë vetëm me gjysmë zëri kanë folur për dhunën seksuale, besohet se edhe rastet e dokumentuara në raporte të veçanta paraqesin vetëm një pjesë të dhunës seksuale që ka ndodhur, pasi që ato janë ndjerë të vetë-izoluara, të përjashtuara nga shoqëria dhe me mundësi të pabarabarta për punësim dhe integrim. Stigma dhe diskriminimi kishin shoqëruar edhe ato raste të rralla ku gratë kishin sfiduar drejtësinë dhe gjykatat, kështu që më shumë krijuan konflikte sesa zgjidhje të tyre. Qasja diskriminuese karrshi grave viktime të DHSBGJ, kishtë bërë që ato të braktiseshin nga familjet e tyre, dhe bashkë me fëmijë të vegjël kishin mbetur pa mundësi strehimi dhe punësimi. Këto viktime kanë jetur në kushte të tilla poshtëruese. Situata jo më e mirë ka karakterizuar edhe gratë e marginalizuara dhe të papërfaqësuar nga radhët e minoriteteve, siç është komuniteti RAE. Kjo kategori më së tepërmi është ndikuar nga martesat me forcë (të hershme), pasuar nga dhuna e shumëfishtë gjinore siç është dhuna fizike, seksuale, abuzimet psikologjike, si dhe mohimi i qasjes në edukim dhe shërbime tjera publike.

Niveli i ulët i shkollimit dhe aftësive teknike së bashku me paragjykimet kulturore dhe shoqërore kanë shkaktuar izolimin dhe qasjen e kufizuar në fuqizimin ekonomik. Të dyja target grupet, në këto regjione, mbesin në gjendje të vështirë socio-ekonomike dhe theksojnë nevojën për qasje në të hyra produktive, trajnime dhe punësim, me qëllim të kompensimit të dëmeve materiale dhe humbjeve të të ardhurave.

2. Pjesëmarrja ekonomike

Një concept i tillë inovativ ofron mundësi për gratë që të konsolidojnë pozicionin e tyre si zotëruese të drejtave të njeriut dhe si familje të pavarura ekonomikisht.

Të dhënat tregojnë se gjendja aktuale e grave të intervistuar karakterizohet nga mungesa e shkollimit bazik, dhe se ato nuk gëzojnë ndonjë mbështetje emergjente në artikullimin e nevojave të tyre.

Argumenti i efikasitetit ekonomik⁸, që përdor të dhëna sasiore, pohon se pjesëmarrja e grave kontribuon në zhvillim, sepse gratë janë më të prirura që të investojnë në komunitet dhe që t'i nxjerrin familjet nga varfëria. Në anën tjetër, përfshirja e grave në ekonomi çon tek një standard më i lartë jetese, rritë produktivitetin dhe kohezionin shoqëror⁹.

3. Fuqizimi ekonomik

Fuqizimi ekonomik është menduar që t'u mundësojë njerëzve të mendojnë përtej mbijetesës ditore. Për shembull, u mundëson familjeve që të marrin vendime mbi investimet në shëndet dhe edukim, dhe të marrin rrezikun e këtyre investimeve me qëllim të rritjes së të ardhurave. Gjithashtu fuqizimi ekonomik, sipas disa të dhënave, mund ta rrisë pjesëmarrjen e grupeve vulnerabël në vendim-marrje. Njëashtu, të dhënat sugjerojnë që, fuqia ekonomike shpeshherë dhe lehtësisht 'konvertohet' në ngritje të statusit shoqëror, apo rritje e fuqisë vendim-marrëse.

8 Naoko Otake, Employment and Labor Market Policies Branch, "Resource Guide on Gender Issues in Employment and Labour Market Policies: Working Towards Women's Economic Empowerment and Gender Equality," (Geneva: International Labour Organization, 2014), 1

9 The International Bank for Reconstruction, Engendering Development: Through Gender Equality in Rights, Resources, and Voice (New York: Oxford University, 2001), 10-11.

Në kontekstin e Kosovës, fuqizimi ekonomik i grave mund të interpretohet si mundësi e adresimit të pabarazisë gjinore; nevojave për ngritje të aftësive profesionale, të drejtave pronësore dhe transformimin e formave të mbrojtjes sociale.

4. Shkathësitë sociale dhe angazhimi personal

Qasja në të cilën shkathësitë sociale dhe personale bëhen mjaft të dukshme, ku gratë viktime të DHSBGJ janë në gjendje që të mbajnë të tjerët përgjegjës, nuk kanë frikë nga identiteti i tyre, kanë një nivel përfaqësimi dhe janë të zëshme, kanë tejkalluar vetë-përrjashtimin dhe kanë aftësitë për të imagjinuar dhe aspiruar një të ardhme më të mirë.

Përfshirja e grave në mekanizmat e komunitetit lokal mund të kontribuojë në fuqizimin shoqëror duke përmirësuar aftësitë e tyre, njohuritë dhe vetë-perceptimin. Grupet vulnerabël, siç janë gratë e varfëra dhe komunitetet e marginalizuara, shpeshherë mund të kenë mungesë të aftësive dhe besimit për t'u angazhur në vendim-marrjen e komunitetit. Kështu që, është mjaft e rëndësishme përkrahja e dizajnit të mekanizmave të cilët në veçanti i targetojnë grupet e marginalizuara, me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së tyre. Është argumentuar që pjesëmarrja në shoqatat lokale mund të fuqizojë njerëzit e varfër që të angazhohen në politikat publike dhe veprimet kolektive.

Me qëllim të promovimit të një qasje të tillë, studimi inkurajon dhe nxitë formimin e partneriteteve midis sektorit publik dhe privat, organizatave jo-qeveritare dhe komuniteteve që ndajnë vlera të përbashkëta dhe janë bazuar në respekt të ndërsjell. Shoqëria civile ka treguar se mund të luajë role të shumëfishta, siç janë roli i monitoruesit, kontributi në hartimin e politikave publike dhe ofrimi i shërbimeve sociale. Shërbimet duhet të ofron për popullsinë në përgjithësi, e në veçanti për të varfërit dhe grupet vulnerabël, gjithnjë duke pasur barazinë gjinore si qëllim të përbashkët. Partneriteti i suksesshëm do ti ngrisë edhe kapacitetet në përgjithësi.

5. Metodologjia e studimit

Ky Studim adreson dy pyetje kërkimore. E para, analizon si dhe në çfarë mase gratë në Kosovë i kanë mbijetuar vështirësive në luftë dhe pas luftës përmes mjeteve formale dhe joformale (*informacioni duhet të përfshij të dhënat dhe rastet nga mizoritë/mbijetimet e luftës, që do të duhet të kishin të drejtë të përfitonin integritetin social, ekonomik dhe moral, reparacionin dhe kompenzimin për të gjitha dëmet e shkaktuara*). E dyta, vlerëson rolin që gratë viktime të DHSBGJ mund ta kenë në realizimin e fuqizimit të barabartë dhe për më tepër, në zhvillimin dhe rindërtimin ekonomik të Kosovës. Duke njohur pjesëmarrjen e tyre në sektorin për zhvillim dhe tregun e punës, ky studim vë në pah se si gratë viktime të DHSBGJ mund të krijojnë dhe përfitojnë nga mundësitë e tanishme ekonomike dhe sociale, se si pjesëmarrja e tyre mund të kontribuojë në fusha të ndryshme të rritjes ekonomike në Kosovë, dhe cilat sfida vazhdojnë të mbesin.

Studimi synon të ofroj një shqyrtim kualitativ mbi gjendjen aktuale të grave përmes mbledhjes dhe analizës së 40 intervistave gjysmë të strukturuar, pasuar nga indikatorët tjerë si: gjendja e këtyre kategorive ku gruaja supozohet të jetë në mesin e individëve më vulnerabël, faktorët kryesorë që nënvizojnë gjendjen socio-ekonomike, edukimi, statusi

shëndetësor and (pa) aftësitë. Studimi është kryer në dy regjione të veçanta në Kosovë. Intervistat janë mbledhur bazuar në aftësinë e grave në artikulin e nevojave dhe vështirësive.

Procesi i anketimit është bërë i mundur nga bashkëpunimi i partnerëve implementues. Gjithashtu, zgjedhja e vendit për anketim është bërë në respektim të plotë të parimit “Mos bëj dëm”. 40 gra janë përzgjedhur nga takimet dhe trajnimet e mbajtura në Drenas/Glogovac; pastaj tregimet të cilat janë ndarë nga gratë që kanë vuajtur pasojat e luftës, u kanë mbijetuar dhunës seksuale dhe asaj në baza gjinore, kanë humbur familjarët dhe të afërmit e tyre. Vëmendje e vecantë i është kushtuar grave dhe vajzave nga komuniteti RAE në Gjilan/Gnjilane, të ekspozuara ndaj DHSBGJ dhe diskriminimit. Përrjashtimi i burrave nga këto takime ka bërë që për një nuancë të humbas kultura e barazisë gjinore. Prandaj, ky studim nuk paraqet një analizë të plotë për përbërjen gjinore në pjesëmarrjen ekonomike, por, nga afër shqyrton dhe analizon vetëm rolin që kjo kategori shumë specifike e grave/të mbijetuara mund ta luaj përmes angazhimit aktiv në fushën ekonomike dhe sociale, në Kosovë.

Intervistat gjysmë të strukturuara janë mbajtur në Qendrën për Promovimin e Drejtave të Grave në Drenas/Glogovac, ku është paracaktuar arritja e një ekuilibri në mes të qëndrueshmërisë dhe fleksibilitetit të informacionit të marrë. Dy pyetësorë – nga një secilën pyetje hulumtuese – për secilin takim janë përshtatur bazuar në rrethanat, përvojën dhe njohuritë e individit që është intervistuar. Pyetjet janë dizajnuar në mënyrë që të sigurojnë neutralitetin dhe marrjen e informacioneve specifike lidhur me pyetjen hulumtuese. Intervistat kanë qenë fleksibile, ku gratë kanë mundur t’i elaborojnë përgjigjet e tyre përtej pyetjeve formale, përshkak se kjo krijon një ambient më të përçueshëm dhe më kolegial për qëllimet e një studimi kualitativ. Të gjithë të intervistuarit kanë marrë pjesë vullnetarisht dhe kanë dhënë pëlqimin për saktësinë dhe plotësinë e informacionit.

Meqenëse konfidencialiteti i të mbijetuarve mbetet një shqetësim kyç, detajet që do të mund të identifikonin ndonjë individ të mbijetuar, apo zonat ku ata bonojnë do të çonin në vet-identifikimin e tyre, janë hequr nga procesi i grumbullimit të të dhënave.

Rezultatet e studimit mbesin një punë kolegjiale e rishikimit të literaturës ekzistuese ligjore dhe dokumenteve politike (strategjive) dhe vlerësimeve të ekspertëve të pavarur. Në përgjithësi, gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave dhe analizës (kualitative dhe kuantitative) mbi ndikimin e luftës në jetën e grave dhe familjeve të tyre, janë konsultuar ekspertët e fushës dhe facilitatorët nga QPHSH, QKRMT dhe QPDG Drenas (konkretisht njerëzit që në fakt trajtojnë individët nga grupet e targetuara, drejtuesit të cilët janë përgjegjës për mirëfunksionimin e shërbimeve sociale dhe skemave ekonomike)¹⁰.

¹⁰ Shih Shtojca 1: Pyetsori

6. Të gjeturat kryesore dhe konkluzionet

6.1 Realitete sfiduese:

Gjendja aktuale e të mbijetuarve të luftës, viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit mbetet në limitet e dëshpërimit.

Të dhënat tregojnë që “ të 40 gratë e intervistuarat kanë raportuar që dijnë ose kanë përjetuar dhunë, rrahje, kanë humbur anëtarët e familjes, kanë humbur bashkëshortët apo janë dhunuar”. Këto të dhëna janë marrë nga një grup i vogël i grave, të cilat vullnetarisht janë afruar me ekipin, apo kanë marrë pjesë nëpër aktivitete të ndryshme programore. Gratë të mbijetuarat përfaqësojnë një grup të popullsisë nga moshat 32-68 vjeçare, me problem të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat civile, sociale dhe ekonomike. Shumë nga to vuajnë nga çrregullimet e stresit post-traumatik, ato janë të heshtura, ndonjëherë të frikësuar, sikur intervistat do të thyejnë realitetin e tyre të heshtur.

Në kontekstin aktual, mungesa e kapaciteteve profesionale e institucioneve shtetërore për qasje në drejtësi dhe rehabilitim (Neni 14 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës) mund t'i atribuohet faktorëve të ndryshëm:

- Heshtja e të mbijetuarve pas përfundimit të konfliktit të armatosur, frika nga stigmatizimi kombinuar me kërcënimet në vazhdimësi janë rritur: të gjitha intervistat pohojnë ngurrimin e grave/të mbijetuarat për të folur, ato që kanë përjetuar krimet dhe përdhunimin në të njëjtin vend, kanë premtur që asnjëherë nuk do të flasin për atë se çfarë u ka ndodhur.
- Në mungesë të vetëdijes publike mbi seriozitetin e aktit, as të mbijetuarat por as ndonjë i afërm i tyre nuk ndihen të sigurt që të sfidojnë konceptin tradicional të “nderit dhe krenarisë”; dhe të jenë në gjendje që të dëshmojnë në seancat gjyqësore penale.
- Mungesa e përkrahjes përmes shërbimeve publike sistematike dhe gjithpërfshirëse për të mbijetuarat ka ndikime negative në jetën e tyre.
- Duke qenë se krimet kanë ndodhur para shumë kohësh dhe nuk janë hetuar ashtu sic duhet, kjo situatë ka krijuar dyer “imagjinare” kundër mundësisë për rehabilitim dhe shërim të viktimave. Gjatë diskutimeve, është dëshmuar që viktimat japin mbështetje të pakusht për njëri-tjetrin.

6.2 Profilizimi i grave të mbijetuarat të DHSBGJ

Të dhënat nga 40 intervistat me gratë tregojnë se gjithmonë është sfida e madhe profilizimi i një gruaje viktimë e DHSBGJ. Sfidat kanë të bëjnë me mënyrën e jetesës, kontekstin familjar, edukimin, prapvijën profesionale, mirëqenien në familje etj.

Pothuajse të gjitha të intervistuarat kanë lindur dhe janë rritur në familje tradicionale me parime dhe vlera të caktuara morale dhe religjioze, dhe se ndër breza tjetërkush është kujdesur për to.

Ato kanë treguar nivel të ulët të shkathtësive teknike dhe profesionale, por një situatë e tillë është pasojë e pasigurive për punësim dhe mungesës së të drejtave pronësore.

Intervistimi identifikoi vetëm 5 gra që ishin të afta në artikullimin e interesave të tyre dhe

që kërkonin mbështetje kundër simptomave fizike dhe psikologjike nga ankthi, frika dhe stigma. Një e mbijetuar deklaroi që *“ndihet sikur dëshiron ta godasë fqinjën e saj, sa herë që ajo kalon pranë saj dhe nuk i flet, përderisa të dyja ishim dhunuar”*. Një tjetër e mbijetuar shpreh gjendjen e saj mendore *“kur shikoj lajme apo ngjarje të dhunshme, vështirë se mund ta tejkaloj, kështu që sëmurem për 3 ditët e ardhshme, duke përjetuar ankth, dhimbje koke, të vjella etj.”* Një tjetër e mbijetuar tregon për strategjinë që ajo ndjek për të mbijetuar *“mundohem të jem sa më positive për të qenë ende gjallë”, “vete-konsultimet në mes grave që kanë përjetuar gjëra të ngjajshme”*. Ndërsa 35 të intervistuarat tjera ngurrojnë që të flasin ndaj një procesi që mund të jetë vetë-identifikues.

Në anën tjetër, gratë dhe vajzat nga komuniteti RAE kanë raportuar varfëri të skajshme, mungesë edukimi, mungesë të aftësive të fituara dhe aftësi të kufizuara. Sipas informacionit të marrë nga zyra komunale për komunitete dhe të kthyer dhe bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, nga 90,178 banorë të regjistruar në komunën e Gjilanit/Gnjilane, 361 janë Romë, 15 Ashkali dhe 1 Egjiptian, megjithkëtë sipas Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), në fakt janë mbi 400 anëtarë të komunitetit Romë që jetojnë vetëm në qytetin e Gjilanit/Gnjilane, veçanërisht në pesë lagjet urbane. Meqenëse numri i Ashkalinjëve dhe Egjiptasëve është dukshëm më i vogël, vlerësimet e më poshtme do të fokusohen kryesisht në gjendjen e komunitetit Romë në Kosovë, veçanërisht në gjendjen e grave të këtij komuniteti. Është vërejtur që pozita e marginalizuar e grave nga ky komunitet vjen si pasojë e disa faktorëve social të cilët e komplementojnë njëri tjetrin: 1) shkalla e lartë e papunësisë 2) mungesa e shkollimit adekuat, 3) mungesa e shkollimit/kualifikimit profesional, 4) integrimi socio-ekonomik, 5) mungesa e vullnetit politik për të ndërmarrë aktivitete afirmative në mbështetje të grave të këtij komuniteti, 6) dhe sundimi i stigmës për statusin e tyre në shoqëri.

Gjatë intervistave me gra, disa nga to deklaruan që ishin angazhuar në punë sezonale duke punuar në agrokulturë dhe punë dore artizanale. Varfëria mbetet sfida kryesore për këto gra, duke bërë të pa përbalueshëm regjistrin në zyrat civile dhe nxjerrjen e dokumenteve personale, të cilat janë të domosdoshme për ndonjë punësim eventual. Pothuajse, të gjithë të intervistuarit kanë raportuar problem dhe vështirësi në qasjen e shërbimeve (kujdesit shëndetësor, social, komunal, dhe shërbimeve publike).

Në një afat të gjatë dhe si rezultat i mbivendosjes së problemeve, është e përbashkët e individëve të këtyre grupeve që shpehsherë ballafaqohen me sfida të natyrës ekonomike dhe sociale. Gjithashtu, jo rrallë ata diskriminohen kundër qasjes në shërbimet bazike, privohen nga mundësitë për punësim për shkak të mungesës së edukimit adekuat, ku për pasojë bëhen të varur nga përfitimet sociale. Në krye të kësaj qëndrojnë, rastet e punësimit të fëmijëve, martesat e hershme dhe lindjet e hershme të fëmijëve në këtë komunitet janë raportuar nga akterë të ndryshëm të drejtave të njeriut dhe media, por për këtë temë nuk ka të dhëna të sakta dhe zyrtare nga zyra për komunitete dhe të kthyer në Gjilan/Gnjilane.

6.3 Dokumentimi i dëmeve shogërore:

Deri më sot, në mënyrë sistematike janë bërë përpjekje për të mbledhur të dhëna dhe për të krijuar dosje lidhur me dhunimet e kryera gjatë konfliktit, për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Përkundër, ekzistimit të kornizës ligjore, dhe mekanizmave të ndryshëm qeveritar dhe jo-qeveritar, ende është e nevojshme dokumentimi i duhur i

krimeve të luftës dhe ndikimeve të saj.

Nga 40 të intervistuarat, 23 prej tyre treguan se kjo ishte hera e parë “që ato folën për atë se çfarë u kishte shkaktuar lufta”. Përkundër dëmeve financiare (shtëpi të djegura, dëbimeve, humbjes së ekonomive familjare etj) ato treguan për problemet që ndërlidhën me jetën e tyre të përditshme dhe komunitetin e mbyllur në të cilin jetojnë.

Për disa nga gratë, lufta i ka ndryshuar komunitetet në kuptimin e humbjes së kontakteve, individualizimit dhe mbylljes së familjeve, si dhe ka ndryshuar raportet midis anëtarëve të familjes. Për disa gra të tjera, lufta ka shkatërruar të gjitha vlerat që familja kishte, ato ndihen të braktisura, pa mundësi për punësim, pa ekonomi private dhe pa mbështetje në familje.

Gratë tregojnë për ndjenjën e turp, mosbesimit në autoritetet lokale, dhe ndonjëherë informimin e gabuar mbi të drejtat dhe statusin e të mbijetuarve të DHSBGJ. Statusi i tyre komplikohet edhe më shumë për shkak të stigmatizimit që ndërlidhet me dhunimin dhe përjashtimin që u bëhet nga komuniteti i tyre dhe anëtarët e familjes.

Gjithashtu, 31 nga 40 gratë shprehin shqetësimin se si do të mund t’ua shpjegojnë të tjerëve prejardhjen e parave, apo si do të mund t’i fshihnin pensionet nga familjet e tyre. Shumë nga to frikësohen se kjo do të çonte në identifikimin e tyre, çka do të nënkuptonte dhunë potenciale dhe stigmatizim. Janë një numër i konsiderueshëm i pasojave sociale të dhunës seksuale brenda familjes dhe komunitetit të viktimave: disa nga të mbijetuarat janë braktisur nga bashkëshorti për shkak të stigmës dhe neverisë. Një grua shpjegon: “*I tregova burrit se çfarë më kishte ndodhur, ai më braktisi më fëmijët dhe kurrë më nuk u kthya. Tani jetoj nga asistencë sociale dhe jam shpërngulur.*”

Një grua e pamartuar, ndihet e shkatërruar duke theksuar që ato ishin stigmatizuar jo vetëm nga bashkëshortët e mundshëm por edhe nga vjehrrat e ardhshme. Një e mbijetuar tjetër shpjegon se si “*Disa gra të reja që ishin dhunuar, kurrë më nuk kishin arritur që të gjenin një burrë.*”

Për më tepër, të mbijetuarat përgjithësisht jo vetëm që kanë qenë të refuzuara nga familjet e tyre, partnerët dhe komuniteti, por edhe janë abuzuar. Këtë stigmatizim dhe abuzim ato e kanë përbrendësuar duke u mbyllur në vetëvete. Gjithashtu, si rezultat i stigmës, shumë nga të mbijetuarit e dhunës seksuale mbesin “*të mbyllura në shtëpitë e tyre... bashkë me traumën në kokën e tyre.*”

Në përgjithësi, mungesa e informacionit dhe njohjes ka ngritur shumë shqetësime serioze për shumë gra që ballafaqohen me dhunën në baza gjinore dhe dhunën në familje e cila vjen nga bashkëshortët/të afërmit e tyre. Një realitet i tillë sjell nevojën e priorizimit të krimeve kundër gruas në mekanizmat e drejtësisë tranzicionale, përmes adresimit të të drejtave të tyre në reparacion (duke përfshi të drejtën për kompensim individual, shëndetësi, edukim dhe punësim); duke pasur parasysh, që obligimi fundamental i një skeme të tillë për reparacione nuk ka të bëjë aq shumë me kthimin e gjendjes siç ka qenë më parë, por për të njohur seriozitetin e shkeljes së të drejtave të bashkëqytetarëve dhe për t’i bërë mekanizmat qeveritarë që t’i respektojnë këto të drejta.

Ndonëse, “vetëm pak gra kishin fatin që të gëzojnë përkrahjen e familjeve të tyre”, disa familje dhe komunitete i trajtojnë viktimat më mirë sesa të tjerat. Siç shprehet një e mbijetuar: *se si njerëzit e shikojnë një grua e cila ka përjetuar këtë dhunë, kjo varet nga mentaliteti. Disa i shohin ato si kriminelë dhe se duhet të kenë turp. Do të dëshiroja të kasha një program televiziv, ku do të mund t’ju tregonim njerëzve që nuk jemi të këqija.*” Kjo tregon nevojën për ngritjen e vetëdijes me qëllim të luftimit të stigmës dhe paragjykit, diskriminimit dhe braktisjes, veçanarisht brenda familjes dhe komunitetit.

6.4 Kontekstet ligjore dhe institucionale:

Në kontekstin e Kosovës, korniza eksistuese ligjore dhe institucionale mbi të drejtat e grave, fuqizimin dhe përkrahjen sociale të grupeve vulnerabël është modern. Në pajtueshmëri me këto zhvillime, Ligjit nr. 04/L-172 për amandamentimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, e njëj statusin e viktimave civile të luftës dhe beneficionet personale për viktimat e dhunës seksuale.

Si përgjigje e rekomandimeve të shoqërisë civile (organizatat të cilat ofrojnë shërbime dhe organizatat e grave që përfaqësojnë gratë/të mbijetuara), disa iniciativa dhe kampanja vetëdijësuese ishin inicuar nga zyra e Presidentës të Republikës së Kosovës, të cilat kulmuan me themelimin e Komisionit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale, i cili veprimi si një mekanizëm mbështetës dhe koordinues i njohjes së statusit dhe të drejtave të viktimave të dhunës seksuale, qasjes në drejtësi dhe mundësive për fuqizim ekonomik. Ky proces u pasua nga zhvillimi i legjislacionit sekondar, i cili parashikon themelimin e një Komisioni që do të verifikonte statusin dhe njohjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale.

Përkundër garancive ligjore, gratë e intervistuarat e kanë të vështirë qasjen në informacionin lidhur me kuadrin ligjor i cili verifikon zyrtarisht statusin e të qenurit viktimë e dhunës seksuale nga koha e luftës, beneficionet, si dhe proceset që po ndërmerren për themelimin e Komisionit.

Ato e kanë të vështirë përcjelljen në mënyrë periodike të informacioneve që ofron nga ana e autoriteteve. Gjithashtu, saktësia e informacioneve mbetet problematike. Keqinformimet e tilla lidhur me proceset e bëjnë këtë edhe më të sfidueshme duke rritur frustrimet dhe pakënaqësitë me qeverinë.

Kur u pyetën lidhur me programet apo shërbimet tjera dedikuar reparacioneve, ato hezituan që të komentojnë, me sa duket për shkak të mungesës së informacionit lidhur me kuptimin e reparacionit, por edhe për shkak të faktit se retorika të tilla mbeten në nivele të larta të politikës, pa ndonjë ndikim dhe strategji të qartë në nivelet lokale.

6.5 Fuqizimi ekonomik si përgjigje ndaj përjashtimit shoqëror:

Analizat e studimit dhe mbledhja e të dhënave ka kuantifikuar indikatorë të posacëm që gjenerojnë fuqizimin ekonomik dhe vetë-qëndrueshmërinë.

Pothuajse të gjitha gratë që kanë marrë pjesë në intervistim dhe në takime kanë shprehur dëshirën dhe vullnetin për punë, e që kryesisht varet nga vendi i tyre i banimit (rural/urban).

Kryesisht gratë shprehin vullnetin për të punuar punë-dore, bujqësi, bletari, rrobaqepësi, parukeri dhe përpunimin e ushqimit. Përkrahja e tillë nuk do t'ua jepte mundësinë që të blenin shtëpi të reja apo të hapnin ndërmarrje / biznese të vogla (dyqane), por do të ndërtonte ndjenjën e zotërimit dhe punës në grup (*e cila rrezikonte që të humbej apo ishte e vështirë që të mbahej*).

Të gjitha gratë shprehën nevojën për informacion praktik lidhur me të drejtat ekonomike dhe pensionet, si dhe statusin e viktimave civile të luftës. Disa nga to ishin në dijeni për ndërlidhshmërinë e tërë procesit me përkrahjen financiare, përderisa të tjerat kishin nevojë për më tepër informacion për përkrahjen potenciale në shëndetësi dhe edukimin e fëmijëve të tyre.

24 gra e lidhnin fuqizimin ekonomik vetëm përmes përkrahjes komunale për gra, programeve lokale, tranimeve dhe kurseve për gra me qëllim hapjen e bizneseve të vogla familjare, si dhe përkrahjen në integrimin dhe rehabilitimin e tyre si të mbijetuara të luftës.

Neglizhimi i nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë dhe pas luftës, si dhe traumat e pas luftës, gjithashtu ishin ngritur si shqetësime serioze, duke përfshi edhe mungesën e shërbimeve adekuate. Pamundësia e qasjes në edukim, trajnim dhe punësim ka pasoja negative për të mbijetuarit dhe familjet e tyre. Gjithashtu, ajo ka mundësi për të kaluar brezat, duke kufizuar mundësitë dhe mbijetesën për gjeneratat e ardhshme.

Përkundër përpjekjeve për vetë-punësim, disa nga gratë deklaruan se me qëlim të mbajtjes së aktiviteteve të cilat gjenerojnë të ardhura, ato hasin në vështirësi dhe kanë mundësi të vogla që t'i shesin produktet e tyre. Kështu që, nevoja për një strategji lokale që do t'i trajtonte bizneset apo aktivitetet që sigurojnë vetë-qëndrueshmëri mbetet një sfidë e vërtetë, e cila i bën thirrje tërë sektorit të shërbimeve sociale për të vepruar dhe kërkuar zgjidhje.

6.6 Ekonomia sociale dhe roli i sektorit civil si përgjigje ndaj krizës së shtetit social

Në konceptimin e grupeve vetë mbështetëse dhe angazhimit në komunitet, roli i akterëve të shoqërisë civile bëhet krucial në realizimin e aktiviteteve avokuese, mobilizimin e qytetarëve dhe komuniteteve lokale, në kërkim të përgjigjeve të drejtpërdrejta.

Në rastin e Kosovës, organizatat mund të jenë mundësi e mirë në ndërtimin e kapaciteteve sociale (p.sh. duke punësuar apo trajnuar grupet shoqërore të pafavorizuara) dhe reagimin ndaj kushteve të pavolitshme (p.sh. strehimin për familjet me të ardhura të vogla, trajnime profesionale për gratë/të mbijetuara, mikro financime për vetë-punësim etj) – në kontekst të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve për mirëqenien ekonomike dhe sociale të komuniteteve lokale.

Indikacione të tilla vijnë nga të gjithë të intervistuarat, të cilat kanë shprehur nevojën për rigjenerim ekonomik (bashkëpunimet, partneritetet) dhe krijimin e vendeve të punës (projektet vetë ndihmuese). Sipas tyre, të gjitha këto mund të arrihen vetëm përmes përkrahjes së komunave, dhe autoriteteve lokale në bashkëpunim me OJQ-të të cilat veprojnë në këto fusha.

Gjithashtu, 17 nga të mbijetuarat kanë shprehur pakënaqësi për mungesën e mundësive për punësim për fëmijët e tyre. Në kushte të mungesës së mundësive për punësim, për fëmijët e tyre, e ardhmja e këtyre familjeve është e pa sigurt. Disa nga pjesëmarrësit kanë theksuar se fëmijët e tyre duan të largohen jashtë vendit si “shpëtim” nga gjendja aktuale dhe problemet e tyre.

Konkluzionet

Përkundër, ekzistimit të kornizës ligjore, dhe mekanizmave të ndryshëm qeveritar dhe jo-qeveritar, ende është e nevojshme dokumentimi i duhur i krimeve të luftës dhe ndikimeve të saj.

Gjendja aktuale e të mbijetuarve të luftës, viktimave të dhunës seksuale dhe përdhunimit mbetet në limitet e dëshpërimit. Në një afat të gjatë dhe si rezultat i mbivendosjes së problemeve, është e përbashkët e individëve të këtyre grupeve që shprehshërë ballafaqohen me sfida të natyrës ekonomike dhe sociale. Gjithashtu, jo rrallë ata diskriminohen kundër qasjes në shërbimet bazike, privohen nga mundësitë për punësim për shkak të mungesës së edukimit adekuat, ku për pasojë bëhen të varur nga përfitimet sociale.

Viktimat përfaqësojnë gratë që kanë lindur dhe janë rritur në familje tradicionale me parime dhe vlera të caktuara morale dhe religjioze, dhe se ndër breza tjetër është kujdesur për to. Ato kanë treguar nivel të ulët të shkathtësive teknike dhe profesionale, por një situatë e tillë është pasojë e pasigurive për punësim dhe mungesës së të drejtave pronësore. Në anën tjetër, gratë dhe vajzat nga komuniteti RAE kanë raportuar varfëri të skajshme, mungesë edukimi, mungesë të aftësive të fituara dhe aftësi të kufizuara.

Mungesa e informacionit dhe njohjes ka ngritur shumë shqetësime serioze për shumë gra që ballafaqohen me dhunën në baza gjinore dhe dhunën në familje e cila vjen nga bashkëshortët / të afërmit e tyre. Kjo tregon nevojën për ngritjen e vetëdijes me qëllim të luftimit të stigmës dhe paragjykit, diskriminimit dhe braktisjes, vecanarisht brenda familjes dhe komunitetit.

Niveli i ulët i shkollimit dhe aftësive teknike së bashku me paragjykimet kulturore dhe shoqërore kanë shkaktuar izolimin dhe qasjen e kufizuar në fuqizimin ekonomik. Të dyja target grupet, në këto regjione, mbesin në gjendje të vështirë socio-ekonomike dhe theksojnë nevojën për qasje në të hyra produktive, trajnime dhe punësim, me qëllim të kompensimit të dëmeve materiale dhe humbjeve të ardhurave. Prandaj, në këtë kontekst, është e rëndësishme që të alternohen zhvillimet institucionale me shërbimet rehabilitative për të mbijetuarit në çështje të ndjeshme gjinore, gjithashtu ky alternativim të shërbejë si një mjet në mbështetje të fuqizimit dhe avokimit, edukimit, punësimit dhe të ardhurave.

Gjithashtu, sjell nevojën e prioritizimit të krimeve kundër gruas në mekanizmat e drejtësisë transicionale, përmes adresimit të të drejtave të tyre në reparacion (duke përfshi të drejtën për kompensim individual, shëndetësi, edukim dhe punësim); duke pasur parasysh, që obligimi fundamental i një skeme të tillë për reparacione nuk ka të bëjë aq shumë me kthimin e gjendjes sic ka qenë më parë, por për të njohur seriozitetin e shkeljes së të drejtave të bashkëqytetarëve dhe për ti bërë mekanizmat qeveritarë që ti respektojnë këto të drejta.

Mungesa e përkrahjes përmes shërbimeve publike sistematike dhe gjithpërfshirëse për të mbijetuarit ka ndikime negative në ekzistencën e viktimave. Me një përqindje të lartë të rasteve të pa raportuara të DHSBGJ, viktimat do të vazhdojnë të mbesin në një gjendje të tillë, në rast se Qeveria nuk angazhohet dhe nuk i jep fund neglizhimit dhe diskriminimit dhe të ofrojë politika që i dedikohen fuqizimit ekonomik të grave dhe përfshirjes sociale.

Në konceptimin e grupeve vetë mbështetëse dhe angazhimit në komunitet, roli i akterëve të shoqërisë civile bëhet crucial në realizimin e aktiviteteve avokuese, mobilizimin e qytetarëve dhe komuniteteve lokale, në kërkim të përgjigjeve të drejtpërdrejta. Në rastin e Kosovës, organizatat mund të jenë mundësi e mirë në ndërtimin e kapaciteteve sociale (p.sh. duke punësuar apo trajnuar grupet shoqërore të pafavorizuara) dhe reagimin ndaj kushteve të pavolitshme (p.sh. strehimin për familjet me të ardhura të vogla, trajnime profesionale për gratë/të mbijetuara, mikro financime për vetë-punësim etj) – në kontekst të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve për mirëqenien ekonomike dhe sociale të komuniteteve lokale, duke demonstruar që faktorët kulturor dhe normativ të cilët pengojnë gratë të mbijetuara në pjesëmarrjen e plotë ekonomike mund të tejkalohen dhe të adresohen në formën e duhur përmes legjislationit dhe strategjive bashkëkohore dedikuar përfshirjes ekonomike dhe fuqizimit të grave.

Rekomandimet:

- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive dhe angazhimi i të mbijetuarve në procesin e njohjes, duke pasur parasysh që viktimat nuk kanë vetëm nevojë por edhe të drejta, të cilat duhet të respektohen nga personat përgjegjës (p.sh. shteti, aktorët jo shtetëror, komuniteti familja dhe individët).
- Garantimi i të drejtës për të vërtetën dhe pajtim për të mbijetuarit; duke i siguruar që ri-viktimizimi nuk do të ndodhë asnjëherë.
- Sigurimi i qasjes gjithpërfshirëse dhe holistike ndaj të drejtave të tyre për kompensim në pajtueshmëri me parimin “MOS BËJË DËM”
- Fuqizimi i të mbijetuarve përmes prioritizimit të autonomisë së tyre dhe pjesëmarrjes në proceset vendim-marrëse si dhe përshtatja me kapacitetet e tyre në zhvillim
- Sigurimi i mundësive të barabarta në edukim dhe punësim, si dhe sigurimi i qasjes bazuar në të drejtat e njeriut në proceset politik bërëse dhe vendim-marrëse
- Prioritizimi i përfshirjes së të mbijetuarve në krijimin e vendeve të punës, si dhe në aktivitetet për zhvillime strategjike dhe ekonomike
- Ndërtimi i partneritetit dhe bashkëpunimit në mes të entiteteve publike dhe private me ndërveprimin e zyrtarëve komunalë – konkretisht përmes ZKKK, përderisa shërbimet duhet të ofron për popullsinë në përgjithësi, e në veçanti për të varfërit dhe grupet vulnerabël, gjithnjë duke pasur barazinë gjinore si qëllim të përbashkët
- Ngritja e përgjegjësive të akterëve kryesorë komunal në identifikimin dhe përpilimin e një liste të nevojave që do të zhvillohen më tej nga ZKKK, sidomos në lidhje me planet për buxhetim që u përgjigjet nevojave gjinore
- Inicimi i ndërveprimit dhe bashkëpunimit në mes të grave të komunitetit Romë në komunën e Gjilanit dhe zyrtarëve komunalë, si dhe implemtimi i programeve mentoruese nga ana e sektorit të OJQ-ve me përvojë
- Integrimi i familjeve Rome që së fundmi janë rikthyer në komunitetet e mëdha, në bashkëpunim me zyrtarët komunal dhe Komitetit për barazi gjinore
- Inicimi i aktiviteteve të cilat përfshijnë gratë Rome në trajnime për biznese të vogla, mundësuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Agrokulturë, e cila së shpejti, konkretisht me 8 Mars 2017 do të lansojë strategjinë se si ti përkrahim gratë në biznes
- Fuqizimi ekonomik i grave të përfshihet në nivel të politikave ekonomike nacionale si mundësi e punësimit dhe integritit të tyre
- Zbatimi i legjislacionit në fuqi ,të aplikohet në aspekt të shëndetësisë ,edukim,riaftësim,punësim
- Të organizohen kampanja vetedijësuese sa i përket informacioneve dhe njohjen e të drejtave të viktimave të cilat iu takojnë me ligj
- Studimi të përfshihet në nivel nacional

Falenderime

Partnerët Implementues shprehin mirënjohjen e tyre për të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës në Kosovë, të cilët ndanë tregimet, informacionet dhe nevojat e tyre, përgjatë implementimit të programit dhe përgatitjes së këtij studimi.

Studimi ka për qëllim avancimin e kërkesave dhe zërit të tyre për zgjidhje të duhur dhe të plotë lidhur me mundësitë e tyre për dëmshpërblim.

Partnerët implementues do të donin ti falenderonin edhe oranzatat dhe profesionistët e përfshirë në përgatitjen e këtij studimi.

Falenderime të veçanta për Erinda Bllaca – Doktor Shkence në të Drejtën Publike Ndërkombëtare, autore e protokolleve dhe e studimit. Falenderojmë edhe institucionet lokale, zyrtarët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në veçanti gratë aktiviste të Drenasit për përkrahjen dhe bashkëpunimin e ngushtë.

Publikimi i këtij studimi u mundësua përmes Programit Angazhimi për Barazi (E4E), financuar nga Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC.



Adresa: Hamëz Jashari Nr.16b/2, Lagja Dodona, Prishtinë 10 000 Kosova,

Tel: +381 38 243 707, 243 708 ,

E-mail: info@krct.org

Webfaqja: www.krct.org



Adresa: Muharrem Fejza, Nr.C15/15, Prishtinë, 10000 Kosova,

Tel: +377 44 353 686,

E-mail: info@qpfsh.org,

Webfaqja: www.qpfsh.org



Adresa: Fehmi e Xhevë Lladrovci, p.n , Glogoc/Drenas, 13000 Kosova,

Tel: +381 38 585 357,

E-mail: gendra-drenas@hotmail.com

Webfaqja: www.qpdg.org